

Sa njihet dhe si pasqyrohet në gazetarinë shqiptare problematika ndërfetare

Sami Neza

Problematika fetare është një ndër subjektet më të reja në gazetarinë shqiptare të postdiktaturës. Në pamje të parë ky realitet të bën të mendosh se gazetaria do ta kishte subjektin e fesë në vëmendje për shkak se përbën së pari një gjë të re për konsumatorin e vet dhe së dyti edhe interes njerëzor e publik. Por asnjëra nga këto pritje nuk është reflektuar më agzetarinë shqiptare.

Problematika e besimit ka pak hapsëirë ne media dhe herë pas here kjo problematikë nuk është tipike shqiptare por e ndikuar nga problematikat ndërkombëtare të çështjeve të fesë. Gazetat e përditshme kanë një vend të vogël për problematikat e fesë. Krahasuar me tematikat e tjera vendi që zënë subjektet që lidhen me fenë nuk janë të përditshme e ndërkaq nuk janë në fokusin egazetave apo reporterëve vecse kur ngjarjet që lidhen me fenë kryqëzohen me ngjarje të tjera të me sfond politik, krinikës së zezë apo lajmet e kulturës.

Gjatë monitorimit që projekti hand to hand i ka bërë media së shkruar vitin që shkoi, konstatohet se tetë gazeta kanë botuar sëbashku gjithsej 36 shkrime me tematikë fetare brenda muajit janar 2010 ose ndryshe pak më shumë se katër shkirm në muaj për secilën. Projekti ka monitoruar gazetat Panorama, Shekulli, Shqip , Shqipatre, Standard, Tirana Observer dhe Koha Jonë dhe në tërësi gjithë shtypin shqiptar por në këtë temë po mbajmë në konsideratë gazetat kryesore në vend. Të gjitha të dhënat për mediat e tjera janë ndërkaq lehtësisht të prekshme në databazen e projektit hand to hand të afalc.

Nga këto Panorama ka botuar pesë artikuj, prej të cilëve një koment dhe katër lajme. Ndërsa tematika e tyre mbështet në subjekte jashtë Shqipërisë në një rast ndërsa në problematikën shqiptare në katër raste.

Gazeta Shekulli ka botuar katër artikuj, dy prej të cilëve komente e dy të tjera janë lajme. Problematika po ashtu ndahet përgjysmë, dy shkrime shtrihen në subjektet shqiptare ndërsa dy të tjera i përkasin subjekteve apo çështjeve jashtë Shqipërisë.

Gazeta shqiptare ka botuar për një muaj pesë artikuj prej të cilave dy komente dhe tre lajme, nga këto tre prej tyre kanë një subjekt që vjen prej vendeve të tjera dhe dy shkrime kanë në qendër të vëmëndjes lajme apo çështje brenda Shqipërisë.

Gazeta Shqip ka gjithsej gjashtë artikuj prej të cilave katër komente dhe dy lajme ndërsa tematikë është jashtë Shqipërisë në tre raste ndërsa në tre rastet tjera është e lidhur me problematikat e vendit.

Pra në këto katër gazeta janë botuar 55 për qind e të gjithë artikujve që janë botuar në tërë shtypin shqiptar brenda një muaji, pra nga gjithsej 36 artikuj të të botuar.

Ndërkaq monitorimi i shtypit në muajin mars tregon se ka artikuj të shtuar lidhur me problematikën fetare. Nga rreth 100 artkuj të botuar për çështje që lidhen me tema të komunikimit ndërkulturor, gjysma prej tyre lidhen drejtëpërsëdrejti me temën e fesë.

Gazeta Panorama ka botuar gjithsej katër shkrime, të gjitha lajme nga të cilat vetëm një është subjekt ndërkombëtar ndërsa tre të tjerë janë subjekt nga tematikat shqiptare për fenë.

Gazeta shekulli ka botuar vetëm tre shkrime, pej të cilave një koment ndërsa që të treja kanë për bazë subjekte që lidhen me Shqipërinë.

Gazeta shqiptare ka botuar gjashtë shkrime, dy prej të cilave komente ndërsa tematika është e shëprndarë në mënyrë të barabartë, gjysmë me subjekte ndërkombëtare dhe gjysma tjetër me subjekte nga Shqipëria.

Gazeta Shqip ka botuar nëntë shkrime prej të cilave vetëm një koment ndërsa tematika e këtyre shkrimeve shtrihet në masë të madhe jashtë vendit në shtatë raste dhe vetëm në dy raste ajo ka për subjekt tematikë shqiptare.

Sic shihet dhe në muajin mars kemi pothuajse të njëjtën hapësirë për problemet fetare si në muajin janar ndërkohë që një ritëm i tillë ruhet pothuajse gjithë muajt e vitit me përjashtim të rasteve kur në Shqipëri ka krizë politike apo probleme të thella të natyrës politike apo konfliktit politik.

Kështu përgjatë muajit maj të vitit të kaluar kur tensioni politik në vënd ishte i ngritur për shkak të grevës së urisë së PS lidhur me transparencën e zgjedhjeve, numri i artikujve që lidhen me problematikat ndërfaqetare ka rënë shumë. Në të gjitha shtypin shqiptar ky numër është gati tre herë më i vogël se sa në muajt e tjerë parardhës çfarë do të thotë se problematika fetare në media konkurohet lehtë nga problematika të tjera.

Sapo kalon kriza vërehet një rritje artikujve që lidhen me çështjet e komunimit ndërfaqetare apo lajme mbi institucionet fetare edhe çështje të besimit. Ta zëmë në muajin shtator të vitit të kaluar numri i artikujve shkoi afërsisht 30, shumë afër mesatares së vitit ndërsa bie sërish në muajin nëntor kur retorika politike bëhet edhe më radikale apo më e dendur.

Vendosja e artikujve në faqet e gazetës varet tërësisht nga vlera lajmore e tyre. Rrallëherë ato zënë vend në faqen e parë vec rasteve kur përbëjnë apo agregohen edhe me tematika të tjera që lidhen kryesisht me luftën kundër terrorizmit në shqipëri (çështja e pronësisë së dy kullave binjake, ngrirja e pasurisë së personave në listën e OKB-së të dyshuar për terrorizëm), lajme të kronikës së zezë (rrahja e hoxhes në Lushnjë) apo të karakterit ndërkulturor (dëbimi i nje myftiu shqiptar nga Kosova, protesat kundë monumentit të nënë Terezës në Shkodër), probleme sociale apo të urbanistikës (ngritja e xhamisë së re në Tiranë, hapja e universitetit islamik, problemi i studentëve me shami në shkollë etj). Në rastet e tjera ato renditen kryesisht te lajmet që lidhen me kronikën (vidhet pjesa e mbetur i ikonostasit në Voskopojë, kapet hajduti i kishave dhe xhamive në Tiranë), ose tek faqet sociale ( si vajzat me shami, asnjë problem për vajtjen në shkollë) etj.

Por një vend të rëndësishëm zënë në shtypin e përditshëm shqiptar edhe lajmet që lidhen me problematikën fetare në botë. Ta zëmë subjekte që lidhen me kishën katolike (skandali i pedofilisë), apo me atë myslimane (çështja e xhamive në Zvicër, apo përdorimi i ferexhesë në Francë), kanë zënë një vend të rëndësishëm në faqet e shtypit shqiptar. Kështu lajmi për referendumin lidhur me minaretë në Zvicër zë një vend të konsiderueshëm të gazetave të përditshme në ditën e fundit të nëntorit 2009 dhe në javën e parë të dhjetorit të po atij viti. Gazetat e datës 30 nëntor, 2009 e trajtojnë gjerësisht çështjen e referendumit në Zvicër (gazeta shqiptare: Referendumi, Zvicra ndalon minaret; shqip: Zvicra i thotë jo ndërtimit të minareve; korrieri: Referendumi, 57% votojnë kunder simbolit mysliman; ). Pasqyrimi i këtij lajmi dhe reagimet për të vazhdojnë edhe një ditë më pas. (standard: Ndalimi i minareve ne Zvicër, reagime te ashpra ne Europe; korrieri: Danimarka kerkon referendum, Italia pro vendimit; gazeta shqiptare:gazeta shqiptare: Vota e Zvicres kunder minareve alarmon BE-ne). Ndërsa në ditën e tretë pas referndumit sërish gazetata shqiptare vazhdojnë të komentojnë lajmin (shqip: Minaret, si lindi amendamenti qe turperon Zvicren; korrieri: Pas Zvicres, "ethet" e minareve mberthejne Francen; Tirana observer: Leter hapur ambasadorit te Zvicres ne Tirane).

Artikujt që lidhen me çështje të fesë dhe komunikimit ndërfitar shkruhen nga të gjithë reportërit e gazetës. Asnjë gazetë nuk ka një reporter të specializuar lidhur me çështjet e fesë dhe ndoshta për herë të parë në Shqipëri, afalç ofroi disa senca trainimesh lidhur me shkrimin e lajmit që lidhet me problemet fetare. Në gazeta mund të shruajnë një lajm me subjekt problelem të fesë një reporter i politikës, një reporter i kronikës, një reporter i kulturës , apo reporter i sociales. Pothuajse mungojnë reporterë të specializuar për këtë fushë qoftë edhe për faktin se edhe pse media ka njëzet vejt liri për të shkruar rreth këtij subjekti ende nuk i ka ndërtuar shtratin profesional të atyre që shkruajnë për çështjet e fesë. Në Shqipëri ka persona të arsimuar mirë me teologjinë islame, katolike apo ortodokse por artikujt e tyre në përgjithësi janë të rënduar me gjuhën e teologjisë dhe në përgjithësi të pozicionuar fort ne favor të besimit fetar që i përket autori. Kjo është arsyeja që ata gjejnë shumë pak vend në mediat e shkruara apo elektronike, me përjashtim të ndonjë rasti (një prift katolik) dhe kryesisht i janë drejtuar internetit dhe rrjeteve sociale ku hedhin në publik mendimet e tyre.

Të katër komunitetet featre në Shqipëri kanë zyrat e tyre të shtypit të cilat komunikojnë rrallë me mediat.

Kryesisht zyrat e shtypit komunikojnë lajme të cilat lidhen me aktivitete të religjionit. Por komunikimet janë edhe për problematika të brendshme por me interes publik të institucionit fetar (zyra e shtypit e komunitetit mysliman; deklaratë shtypi për problemet e pronave të komunitetit myskliman, gara që zhvillohen brenda komunitetit për detyra të rëndësishme të tij, polemika mes aktorëve të ndryshëm të komunitetit mysliman në vend etj), komuniteti katolik herë pas here ka deklarata që lidhen edhe me situata politike në Shqipëri (deklarata pas 21 janarit, e përbashkët për të tre komunitetet, deklarata që lidhen me pjesëmarrjen në votimet e 8 janarit etj), deklarata të zyrës së shtypit të Kishës ortodokse lidhen kryesisht me urime për raste festash dhe është më e tërhequr në raport me dy komunitetet tjera për deklarime lidhur me situata të brendshme të kishës por edhe më situata politike dhe sociale në vend.

Pavarësisht këtyre zyrave të shtypit gazetarët në përgjithësi nuk marrin informacione që lidhen me komunitetet fetare prej këtyre zyrave për shkak se ai informacion që vjen prej tyre është shumë formal ndërsa vetë institucionet fetare janë të mbyllyra ndaj medias me përjashtim të rasteve kur debate për çështje të ndryshme apo lajme që prodhohen atje kapërcejnë kufijtë e instucionit dhe mbërthejnë edhe institucione të tjera. Ta zëmë lajmin për vjedhjen e kishave, gazetarët e marrin në polici, ndërsa debatin për ngritjen e xhamisë në Tiranë gazetarët e marrin nëpërmjet burimeve të ndryshme por rrallëherë në mënyrë formale.

Të paktën dy nga katër komunitetet kryesore kanë edhe shtypin e tyre periodik.

Komuniteti mysliman ka gazetën “Drita islame” që botohet një herë në muaj, komunitetit ortodoks ka “Ngjallja” që po ashtu botohet një herë në muaj.

Në uebet e dy komuniteteve të shqyrtuara atë mysliman dhe atë ortodoks ka faqe informacioni por vetëm komuniteti ortodoks ka rubrikën lajme. Komuniteti mysliman e ka përfshirë atë tek “aktualitet” dhe “aktivitete”. Nëse gjykojmë lidhur me kërkesat e lajmit, pothuajse asnjë prej informacioneve që jepen në uebet e komuniteteve dhe pjesa më e madhe që jepet nga zyrat e shtypit nuk i plotësojnë kushtet e vlerës lajmore.

Megjithatë në raste të ndryshme shumë lajme që nuk plotësojnë vlerat lajmore paraqiten në mënyrë të shkurtuar në gazetatat e përditshme.

Në përgjithësi lajmet që konsiderojnë problemet e komuniteteve fetare në Shqipëri dhe ndërkaq plotësojnë edhe kushtet e një vlere lajmore nuk vijnë prej strukturave formale të informimit të kishave apo xhamisë por prej burimeve të ndryshme të vetë reporterëve që mund të jenë në këto komunitete apo që kanë lidhje për rastin me komunitetet dhe subjektet fetare.

Përgjithësisht trajtimi i subjekteve fetare në shtypin e shkruar është korrekt kur bëhet fjalë për ngjarje që lidhen me kronikën e zezë si vjedhje, rrahje, dhunime apo protesta. Ja si është trajtuar një lajm që ka të bëjë me vjedhjen e kishave, duke iu referuar vetëm titullit të shkrimit: (Gazeta shqiptare: Vidhet e demtohet pak ore para festes fetare, kisha "Shen Ana"; Panorama: Korce, vidhet kisha e dyte brenda javes; shqip: Vidhet ne ditën e festes kisha e Shen Anes; standard: Grabitet dhe demtohet kisha e "Shen-Anes"). Në këtë rast nuk kemi ngjyrim të lajmit por thjesht rrefim në deftore për atë çfarë ka ndodhur. Reporteri nuk ndërhyr fare në lajm. Ai vetëm rrëfen.

Por nuk ndodh kështu në rastet kur lajmi ka për subjekt çështje të fesë të miksuara me politikën, me pronat apo ndonjë rast që lidhet me vetë raportet e feve me njëra tjetrën. Lajmi rreth një letre që kreu i demokristianëve i kishte nisur papës në fillim të dhjetorit të 2009, pak para një vizite të kryeministrit Berisha në Vatikan u pasqyrua në dy ditë në këndvështrime të ndryshme nga shtypi shqiptar. Ditën e parë lajmi ishte për letrën e Ndokës drejtuar Papës ku denoncohej kryeministri Berisha si politikan që kishte mbajtur larg pushtetit katolikët dhe akuzohej se ai kishte vjedhur votat e demokristianëve gjatë zgjedhjeve parlamentare të qershorit të viti 2009. Ky lajm u dha nga gazetata tema, Korrieri, Albania, Shekulli, shqip me titurj e mëposhtëm: Tema: PDK: Berisha diskriminon katolikët; Tiranma Observer: PDK- Papes: Berisha vodhi votat e demokristianeve; albania: Ndoka, leter Papes: "Qeveria e Berishes nuk ka asnje minister katolik"; Korrieri: PDK: Berisha diskriminon katolikët; Shekulli: PDK, peticion Vatikanit per viziten e Berishes; shqip: PDK, peticion Papes, Berisha na vodhi votat. Ndërsa tri ditë më pas kisha katolike shqiptare reagoi lidhur me letrën e kreut të demokristianëve, letër e cila ishte kritike për tekstin që kishte përdorur kreu i demokristianëve në letrën etij drejtuar papës. Shqip: Kisha Katolike: Asnje parti nuk e perfaqeson komunitetin; Standard: Kisha Katolike: Ne nuk perfaqesojme partite politike; Integrimi: Kisha: Politikanë shkoni ne Kuvend, aty per ku jeni votuar; Shqip: Vleresoj rolin dhe paanesine e kishes.

Sic shihet edhe prej përshkrimit të mësipërm, vetëm gazeta shqip ka botuar edhe letrën e demokristianëve, edhe deklaratën e kishës katolike; ndërsa gazetata e tjera dallohen qartazi se kanë botuar respektivisht vetëm një pjesë të polemikës. Gazeta tema, albania, korrieri dhe shekulli kanë botuar vetëm letrën e Ndokës, ndërsa gazeta standard, integrimi kanë botuar vetëm reagimin e kishës katolike. Kjo për shkak se gazetave të ndryshme u shkon për shtat me politikën e tyre editoriale një tekst i ndryshëm lidhur me të njëjtën ngjarje, në rastin konkret me të njëtin subjekt apo polemikë.

#### **Lidhur sa më sipër konkludojmë se:**

- media shqiptare e trajton problematikën fetare mbi terma të përgjithshme.
- problematika fetare njihet në mënyrë përshkruese dhe rrallëherë ka artikuj që e përfshijnë subjekte substanciale të kësaj teme.

-problematika që pasqyrohen më së tepërmi janë lajme që lidhen me kronikën e zezë dhe çështje që lidhen me pozicionim të fesë për çështje të ndryshme si terrorizmi, mbajtja e simboleve fetare etj

-në përgjithësi problematika fetare është pak e pasqyruar në media; së pari se shpesh subjektet nga komunitete nuk përbëjnë ngjarje lajmore dhe së dyti vetë komunitetet kanë komunikim të dobët me mediat

-faktet që lidhen me fenë apo objektete fetare trajtohen korrekt kur në ngjarje përfshihen subjekte asnjans të pamundur për tu ngjyrosur me politikë apo besim: vjedhja e objekteve fetare; festimi i ditëve të shenjta të komuniteteve fetare; por nuk ndodh kështu kur në subjektet fetare përfshihet politika apo subjekte që vendosen përballë njëri tjetrit; psh letra e ndokës për papën; vendosja e bustit të Nënë Terezës në Shkodër etj.

-gjuha dhe terminologjia e përdorur në artikujt me subjekt fenë është asnjansë, kryesisht për shkak të mosnjohjes së problematikë së feve.

**Rekomandojme:**

-Vazhdimin e trainimeve në fushën e shkrimit të lajmit që ka të bëjë me komunikimet ndërfitare

-Futjen në kodin e etikës së mediave edhe të elementëve që kanë të bëjnë me komunikimin ndërfitar

-Ndërtimin e një rrjeti gazetarësh që do të funksionojnë në mediat e tyre lidhur me subjektet që kanë lidhje me fenë. Ky rrjet do të përfitojë nga trainimet.

-Në trainime të përfshihen edhe zyrat e komunikimit të komuniteteve fetare

Qershor 2011